



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

**TV 21**  
**Afërdita Kelmendi**  
**Drejtoreshë**  
**Prishtinë**

**Ankesa Nr. 2012/ 88-KPM vs TV 21**  
**Ref: 1301/010/KPM/a.z.**

**VENDIM**

**Lidhur me Ankesën nr. 2012/88-Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër TV 21**  
**(“Pala Përgjegjëse”)**

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) më datën 28 gusht 2009, ka vendosur që palës përgjegjëse t'i lëshoj licencën për të operuar, si televizion nacional në territorin e Republikës së Kosovës.
2. KPM-ja me 28 gusht 2009, ka nxjerrë Rregulloren KKPM 2009/04 për Komunikimet Komerciale Audio Vizuale. Kjo Rregullore ka hyrë në fuqi më 28 nëntor 2011, me qëllim që të përcaktojë parimet themelore të komunikimit komercial audio-vizual, teleshopingun dhe sponsorimet, për transmetimin e tyre në ofruesit e shërbimeve mediale, duke caktuar edhe sasinë e komunikimit komercial audiovizual të transmetuar nga televizionet dhe radiot, duke përfshirë edhe teleshopingun.
3. Më marrjen e Licencës, Pala Përgjegjëse, ka nënshkruar Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe është obliguar që të respektojë të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, përfshi edhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale audio-vizuale.
4. KPM-ja ka bërë monitorime të vazhdueshme të Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale KKPM 2009/04. Me rastin e monitorimit të programit të transmetuar nga Pala Përgjegjëse me datën 3 korrik 2012, KPM-ja ka gjetur se gjatë kësaj periudhe Pala Përgjegjëse është në shkelje të nenit 15.3 të Rregullores KKPM 2009/04.
5. KPM-ja bazuar në shkeljen e Rregullores KKPM-2009/04, nga ana e Palës Përgjegjëse me datën 10 korrik 2012, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin nga Pala Përgjegjëse është kërkuar të veprojë në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren KKPM-2009/04, në të kundërtën KPM në bazë të Ligjit të KPM-së, do të ndërmerre masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
6. KPM-ja edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, sërish me datën 29 gusht dhe 4 shtator 2012, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KKPM-2009/04. KPM-ja ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje të Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@imc-ko.org

datës 10 korrik 2012, ka përsëritur të njëjtat shkelje dhe nuk ka marrë asnjë veprim përmirësues dhe ka vepruar në kundërshtim të vazhdueshëm me Rregulloren KKPM-2009/04, pasi që ka tejkaluar minutazhin e lejuar brenda një ore për transmetimin e komunikimeve komerciale, që është përcaktuar me nenin 15.3 të Rregullores KKPM-2009/04.

7. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Rregullores KKPM-2009/04, nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 6 shtator 2012 i ka dërguar Vërejtje me shkrim për shkelje të nenit 15.3 të Rregullores KKPM 2009/04. KPM me anë të Vërejtjes më shkrim edhe një herë ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veproj në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM 2009/04, në të kundërtën KPM në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së do të ndërmerr masa ligjore ndaj televizionit 21.
8. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Palës Përgjegjëse, me datën 15 tetor 2012, ka bërë monitorimin e televizionit 21, ku ka gjetur së Vërejtjes me shkrim televizioni 21 ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren KKPM 2009/04.
9. KPM sërish me datën 5 dhjetor 2012, ka bërë monitorimin e televizionit 21 për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KKPM 2009/04. Gjatë monitorimit një javor që i është bërë TV 21, është konstatuar së ky subjekt vazhdon të jetë në shkelje të nenit 15, paragrafi 3, të Rregullores KKPM 2009/04.

#### Analiza Ligjore

10. Komisioni bazuar në faktet e shpërmendura konkludon së Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 15.3, të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audio vizuale KKPM-200904.

Neni 15.3 i Rregullores KKPM 2009/04 përcakton:

*“Komunikimet komerciale audiovizuale në shërbyesit audiovizual komercial privat nuk duhet të kalojnë mesataren ditore prej 12 minutash në orë për çdo orë të kohës së transmetimit gjatë transmetimit ditor”.*

11. KPM duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapat e nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 15.3, pasi vazhdimisht ka tejkaluar minutazhin e lejuar prej 12 minutash për transmetimin e komunikimeve komerciale brenda një ore transmetim.
12. Komisioni, bazuar në raportet e monitorimit, ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes me shkrim ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 15.3 të Rregullores KKPM-2009/04, pasi që ka tejkaluar minutazhin e lejuar prej 12 minutash për transmetimin e komunikimeve komerciale brenda një ore transmetim.
13. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarr asnjë veprim përmirësues në drejtim të respektimit të Rregullores KKPM-2009/04, prandaj KPM si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse merr shkeljet e vazhdueshëm dhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2009/04.
14. Komisioni duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konkludon së Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 15.3 të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audio vizuale KKPM-2009/04.

## Vendim

15. Bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, KPM gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 15 paragrafi 3 të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale KKPM-2009/04.
16. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 15 paragrafi 3 të Rregullores KKPM 2009/04, pasi që ka tejkaluar minutazhin e lejuar prej 12 minutash për transmetimin e komunikimeve komerciale brenda një ore transmetim.
17. Komisioni bazuar në nenin 30 pika 1.3 të Ligjit të KPM-së, vendos që Palës Përgjegjëse t'i shqiptoj dënim me gjobë në shumë prej 15,000.00 (pesëmbëdhjetë) mije euro për shkeljen e nenit 15 paragrafi 3 të Rregullores KKPM 2009/04. Komisioni, gjithashtu kërkon nga ana e Palës Përgjegjëse që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet, të cilat bien ndesh me Rregulloren KKPM 2009/04.
18. Në rast se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të këtij vendimi vazhdon të veprojë në kundërshtim me Rregulloren KKPM-200/04, Komisioni do të ndërmarr masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
19. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm në momentin e pranimit nga ana e Palës Përgjegjëse. Ankesa kundër këtij vendimi nuk e ndalon ekzekutimin e tij sipas nenit 30 paragrafi 2 pika 2 të Ligjit të KPM-së.

## E drejta për Ankesë

20. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42 paragrafi 2 të ligjit të KPM-së.
21. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
22. Bordi për Ankesa mundet që pa dëgjim të hedh poshtë ankesat të cilat nuk janë të bazuara në njërin nga këto dy mundësi, apo të cilat, nën dispozitat e vendosura nga Bordi për Ankesa në pajtueshmëri me paragrafin 2. të nenit 42 të këtij ligji janë të papranueshme sepse janë të pa vlera keqdashëse apo të pabaza.

## Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim

\_\_\_\_\_  
Shefki Ukaj  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur për Media



28.12.2012  
\_\_\_\_\_  
datë